

Rast studimor:

Shtetësia, integrimi dhe regjistrimi i popullsisë në Serbinë jugore

Të mësojmë nga ndërtimi i paqes në Kosovë dhe në Serbi

HYRJE

Në këtë rast studimor analizohet mbështetja e dhënë nga Peaceful Change initiative -PCi (Nisma për ndryshim paqësor) për një aleancë të organizatave lokale në jug të Serbisë, e cila kreu një Iniciativë që kishte për synim rritjen e pjesëmarrjes së pakicës shqiptare të vendit në regjistrimin shtetëror të popullsisë të vitit 2022. Me këtë rast studimor synohet të kontekstualizohet kjo Iniciativë në kuadër të një vizioni më të gjerë për ndërtimin e paqes në Kosovë dhe në Serbi, aty përshkruhen fushat specifike ku është bërë përpjekje të arrihen këto ndryshime, si dhe të analizohen kushtet sociale dhe politike të pas-regjistrimit të popullsisë në mënyrë që të nxirren përfundime në lidhje me ndikimin e saj më të gjerë në marrëdhëniet ndërmjet individëve, institucioneve dhe komuniteteve. Rasti studimor prezanton mësimin e nxjerrë nga aleanca lokale jo formale në lidhje me faktorët kyç për suksesin e ardhshëm të aktiviteteve të tilla. Përveç kësaj, aty ku është e mundur, me këtë studim synohet të nxirren mësim për ndërhyrje të ngjashme në rajon, dhe sidomos për regjistrimin e ardhshëm të popullsisë në Kosovë, fillimisht i planifikuar për vitin 2023. Mësimi nga iniciativa nxjerr në pah konkluzionet e mëposhtme:

- Në zonat që kanë qenë të prekura nga konflikti, ato të marginalizuara ose që i janë nënshtruar abstenimit në aktivitetet e pjesëmarrjes qytetare ose politike, çdo mangësi në organizimin e këtyre proceseve mund të shihet si një përpjekje e qëllimshme për marginalizimin ose diskriminimin. Duhet të bëhen përpjekje specifike për të siguruar disponueshmërinë dhe qartësinë e informatave, shtrirjen proaktive dhe përpjekjet e synuara për përfshirje.
- Organizatat me përvojë të dorës së parë të punës për të përfshirë pakicat dhe grupet e marginalizuara në aktivitetet e pjesëmarrjes qytetare dhe politike janë burim i paçmuar mësimi dhe duhet të përfshihen për të informuar përkitazi me planifikimin e aktiviteteve të ngjashme.
- Udhëheqja politike ishte faktor shumë i rëndësishëm në shmangien e kërcënimit me abstenim. Gjestet e mirëbesimit nga figurat politike dhe angazhimi i hisedarëve ndërkombëtarë, mund të luajnë secili rol kyç për të kontribuar për një mjedis ku ka besim.
- Organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë rol kyç për të mundësuar angazhimin e grupeve të marginalizuara dhe të atyre të pakicave, veçanërisht kur ato kanë lidhje të mëparshme me këtë pjesë të popullsisë.
- Duke marrë pjesë në një aktivitet të tillë si regjistrimi të popullsisë, komunitetet pakicë po demonstrojnë një ndjenjë të angazhimit qytetar dhe të përkatësisë lokale që duhet të promovohet nga institucionet dhe komuniteti shumicë në tërësi.

Sfidat e ndërtimit të paqes në jug të Serbisë

Pakica shqiptare në Serbi banon në tri komuna në jug të vendit - Preshevë, Bujanoc (Qarku Pčinja i Serbisë) dhe Medvegje (Qarku i Jabllanicës)- të cilat gjenden në disa nga zonat më të varfra të vendit. Tensioni me qeverinë qendrore daton të paktën që në kohën e shpërbërjes së Jugosllavisë. Menjëherë pas konfliktit të armatosur brenda Kosovës, në mesin e pakicës shqiptare u ngrit një rezistencë ushtarake. Konflikti i armatosur i drejtpërdrejtë u përfundua zyrtarisht në vitin 2001, me një marrëveshje që përfshinte një marrëveshje policie që do të përfaqësonte përbërjen etnike të këtij rajoni. Megjithatë, aktet

e herë pas herë të dhunës vazhduan për vite më pas. Në vitin 2012 në qendër të Presheves u ngrit një monument për luftëtarët që i rezistuan Serbisë. Largimi i saj me forcë nga qeveria e Serbisë tërhoqi vëmendjen edhe një herë te potenciali për konflikt në këtë rajon dhe nxiti përpjekje më të mëdha ndërkombëtare drejt zgjidhjes së konfliktit. Në vitin 2013, OSBE-ja ndërmjetësoi ndërmjet përfaqësuesve shqiptarë dhe Qeverisë së Serbisë për përgatitjen e një plani shtatëpikësh për të përmirësuar pozitën e popullatës shqiptare.

Plani shtatëpikësh për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje

Plani shtatëpikësh është një dokument zyrtar i Qeverisë së Serbisë ku përvijohen një sërë hapash që qeveria pranon t'i diskutojë me synimin për të përmirësuar pozitën e popullatës shqiptare në zonat e cekura. Shtatë fushat e planit janë:

- përfaqësimi dhe integrimi në institucionet shtetërore
- rimëkëmbja ekonomike
- përdorimi zyrtar i gjuhës
- shkrimet dhe simbolet kombëtare
- decentralizimi në gjyqësor
- arsimi, kultura dhe mediat
- kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale
- masat e sigurisë dhe të ndërtimit të besimit.

Bisedimet për çështjet e theksuara në atë Plan kanë qenë në intervale të rregullta me ndërprerje dhe kanë çuar në hartimin e angazhimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata nga Qeveria e Serbisë, të cilat janë në faza të ndryshme të zbatimit. Plani shtatëpikësh nuk gëzon vizibilitet dhe prani të lartë dhe njihet pak në Serbi, madje edhe në komunitetet që përmenden si përfituese nga ai plan.

Bisedimet për çështjet e theksuara në atë Plan kanë qenë në intervale të rregullta me ndërprerje dhe kanë çuar në hartimin e angazhimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata nga Qeveria e Serbisë, të cilat janë në faza të ndryshme të zbatimit. Plani shtatëpikësh nuk gëzon vizibilitet dhe prani të lartë dhe njihet pak në Serbi, madje edhe në komunitetet që përmenden si përfituese nga ai plan. Pavarësisht se përbëjnë një pjesë shumë të vogël të popullsisë, të drejtat e pakicës shqiptare janë një

temë e përsëritur në marrëdhëniet ndërkombëtare të Serbisë për shkak të lidhjes së tyre të ngushtë me konfliktin e zgjatur me Kosovën. Garancitë e gjera për të drejtat e pakicave të shkruara në Kushtetutën e Kosovës, vëmendja e shpeshtë që i është kushtuar vështirësive me të cilat ballafaqohet komuniteti serb në Kosovë dhe rëndësia e çështjes së krijimit të një asociacioni të komunave me shumicë serbe (AKSHS), që pritët të forcojë sërish të drejtat e pakicës serbe, i ushqen thirrjet e përsëritura si nga shoqëria



Ndërtesa e komunës në Preshevë
Credit: Agon Islami

civile, ashtu edhe nga lidhshipi politik në mesin e shqiptarëve të Serbisë për reciprocitet ndërkufitar në lidhje me të drejtat e pakicave. Ndonëse kjo nuk shihet si perspektivë realiste, rishfaqja e saj e përsëritur, duke përfshirë zërat qytetarë dhe politikë brenda Kosovës, do të thotë se mund të veprojë si pengesë në rrugën drejt arritjes së momenteve të rëndësishme në progresin në normalizimin Kosovë-Serbi, duke përfshirë krijimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe.

Ndonëse sistemi politik serb nuk parashikon përfaqësim të garantuar të pakicës shqiptare, një shqiptar ka qenë anëtar i zgjedhur i Kuvendit Popullor në çdo seancë që nga viti 2006. Në legjislaturën parlamentare gjatë viteve 2020-2022, në një kontekst të interpretuar si afër kapjes së shtetit nga partia në pushtet, përfaqësuesi i pakicës shqiptare shihej si një nga zërat më të rëndësishëm të opozitës brenda institucioneve politike të Serbisë. I njëjti deputet u rizgjodh në zgjedhjet parlamentare të vitit 2023. Ndonëse pjesëmarrja e shqiptarëve në zgjedhje në këtë pjesë të vendit ishte dukshëm më e lartë se në vitin 2022, kjo ishte e pamjaftueshme për të siguruar më shumë se një ulësë në parlament për pakicën shqiptare.

Si një nga pakicat kombëtare të njohura, komuniteti shqiptar zgjedh anëtarët në Këshillin e Pakicave Kombëtare, i cili mund të ushtrojë të drejta në fushën e kulturës, arsimit dhe përdorimit të gjuhës në informim dhe për përdorim zyrtar. Këshilli financohet nga buxheti i Republikës së Serbisë, i pavarur nga buxheti i

njësisë së vetëqeverisjes lokale. Si për buxhetin, ashtu edhe për numrin e anëtarëve merren për bazë informatat nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë. Rrjedhimisht, në vitin 2014, numri i anëtarëve ra nga 29 në 15 pasi një pjesë e madhe e komunitetit shqiptar e bojkotuan regjistrimin shtetëror të popullsisë në vitin 2011. Në vitin 2019, qeveria e Shqipërisë mori vendim për të mbështetur shqiptarët përtej kufijve të saj dhe ta financojë Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Serbi. Që nga ajo kohë, edhe qeveria e Kosovës filloi të japë fonde për komunitetin shqiptar dhe kjo ka shkaktuar më shumë polemika për shkak të statusit të Kosovës që nuk njihet dhe pranohet. Një nga shembujt e shquar lartë është ndalimi i shfaqjes së filmit në Bujanoc, film ky që ishte mbështetur financiarisht nga Qeveria e Kosovës.¹

Në vitin 2000, dhe si përgjigje ndaj krizës në Serbinë jugore, qeveria krijoi Trupin Koordinues për Komunitatet e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes për t'i kushtuar vëmendje të shtuar politikës, sigurisë dhe ekonomisë së rajonit, me detyrë për të përmirësuar standardet e jetesës dhe mbrojtjen e të drejtave. Aktivitetet e Trupit Koordinues e kanë si prioritet arsimin, çështjet sociale, zhvillimin ekonomik dhe forcimin e shoqërisë civile. Ndonëse shumica e punonjësve të Trupit Koordinues janë shqiptarë etnikë, ajo është kritikuar për mos emërimin e shqiptarëve në pozita strategjike dhe udhëheqëse.

[1- Balkan Insight, 17 gusht 2023, "Producenti shqiptar etnik e cilëson ndalimin serb të filmave të tij si censurë"](#)

Pavarësisht këtyre mekanizmave, sidoqoftë, rajoni - dhe popullsia shqiptare në veçanti - vazhdojnë të përjetojnë forma të ndryshme margjinalizimi. Brengë e madhe është praktika e 'pasivizimit të vendbanimit', ku qeveria në esencën e anulon në thelb vendbanimin e personave që nuk janë gjetur të jetojnë në adresën e tyre të paraqitur. Pa dëshmi të vendbanimit, nuk mund të sigurohet qasje në të drejta të tilla si pensionet ose përfitimet tjera. Kjo praktikë ka ndikim konkret në jetën e përditshme, megjithatë ata, vendbanimi i të cilëve është pasivizuar, shpesh nuk informohen dhe nuk janë në dijeni për mekanizmat e ankesës.² Politika e qeverisë i shërben keq fushës së arsimit pasi nxënësit shqiptarë mësojnë për gati 20 vjet nga përmbledhjet e mësimave ose nga tekstet ilegale që devijojnë nga ato shtetërore. Mospërputhjet e shkaktuara nga kjo praktikë përbëjnë një disavantazh serioz për komunitetin shqiptar. Kjo paraqet vështirësi edhe për mësuesit të cilët përgatisin shënime nga tekstet shkollore në gjuhën serbe, të cilat ata i përkthejnë në shqip dhe më pas ua diktojnë nxënësve të tyre gjatë orës së mësimi. Megjithatë kjo situatë u adresua

përfundimisht për nxënësit e shkollave fillore në vitin 2022, nxënësit e shkollave të mesme e nisën vitin shkollor në 2023 pa tekste në gjuhën shqipe. Arsimi në nivelin universitar në gjuhën shqipe ofrohet vetëm në departamentin e Fakultetit Ekonomik në Suboticë në Bujanoc, prandaj kjo është arsyeja se pse një numër i madh i shqiptarëve nga Bujanoci, Presheva dhe Medvegja studiojnë në Kosovë, Maqedoninë e Veriut apo në Shqipëri.

Mungesa e progresit në reciprocitetin ndërkufitar ndërmjet Serbisë dhe Kosovës do të thotë që certifikatat e arsimit të lëshuara nga Qeveria e Kosovës nuk njihen. Njohja e diplomave u vlerësua si çelës për integrimin e shqiptarëve. Kjo çështje ishte pjesë e Planit Shtatëpikësh dhe Marrëveshjes së Uashingtonit (2020), si dhe nismës për të ashtuquajturin "Mini Shengen" të iniciuar në kuadër të Procesit të Berlinit të BE-së. Mosnjohja e diplomave e pengon punësimin në administratën shtetërore, shërbimi shëndetësor dhe gjyqësor, dhe paraqet një tjetër arsye pse të rinjtë shqiptarë largohen drejt vendeve të Evropës Perëndimore.

Konteksti i regjistrimit të popullsisë i vitit 2022

Komuniteti shqiptar në Serbinë jugore e bojkotoi regjistrimin e fundit të popullsisë (në vitin 2011), pjesërisht për shkak të mosmarrëveshjeve rreth gjuhës në të cilën ishin hartuar formularët e regjistrimit të popullsisë dhe shkathtësive gjuhësore të mbledhësve të të dhënave. Ka pasur edhe mosmarrëveshje se si do të regjistroheshin pjesëtarët e diasporës gjatë regjistrimit të popullsisë. Kishte një ndjenjë se bojkoti do të ndihmonte në tërheqjen e vëmendjes ndaj çështjeve të ndryshme të pazgjidhura që kanë të bëjnë me arsimin, gjuhën dhe simbolet, si dhe neglizhencën e përgjithshme ekonomike. Rezultati i bojkotit ishte që u numëruan më pak se 6000 shqiptarë, gjë që më pas pati pasoja të mëtejshme në vendim-marrjen e Qeverisë së Serbisë në lidhje me shpërndarjen e burimeve dhe përfaqësimin e shqiptarëve në institucionet publike.

Përpara regjistrimit të popullsisë të vitit 2022, ishte arritur konsensus i gjerë ndërmjet akterëve

politikë dhe qytetarë për të siguruar një numërim të plotë. Më 25 korrik 2022, përfaqësuesit politikë dhe institucionalë shqiptarë nënshkruan një deklaratë të përbashkët për pjesëmarrje. Deklarata erdhi pas një seri konsultimesh me Misionin e OSBE-së në Serbi dhe Ministrinë e Serbisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave dhe Dialogun Social. Procedurat e publikuara për regjistrimin e ardhshëm të popullsisë (të planifikuara për 1-30 tetor 2022) trajtuan shqetësimet e identifikuar më parë si të rëndësishme për popullsinë pakicë; për shembull, një qytetar mund të regjistronte të gjithë familjen e tij ose të saj pa qenë ata/ato të pranishëm. E rëndësishme është se formularët e regjistrimit të popullsisë do të shtypeshin edhe në gjuhën shqipe. Shmangia e bojkotit në vitin 2022 u lidh gjithashtu me një sens të ripërtërirë qëllimi në lidhje me

[2- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut \(2023\), Pasivizimi i adresave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës si praktikë diskriminuese](#)

zbatimin e Planit Shtatëpikësh për integrimin e komunitetit shqiptar, me Misionin e OSBE-së në Serbi që luante një rol më të fortë. Kjo është përveç faktit se kishte shqetësime të thella për ndikimin që do të kishte bojkoti në ndarjet e

buxhetit komunal për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc nga niveli qendror. Zyrtarët lokalë vunë në dukje gjithashtu se komuniteti mori inkurajim nga Prishtina që shqiptarët 'të ngrihen në këmbë dhe të numërohen'.

Mbështetje për shoqërinë civile për adresimin e sfidave

Planet për kryerjen e regjistrimeve të popullsisë në Kosovë dhe Serbi ishin të njohura mjaft kohë përpara. Përpara çrregullimeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19, vlerësohej se të dy regjistrimet e popullsisë do të mund të zhvilloheshin në kohë të ngjashme. Diskutimet në kuadër të një Grupi Këshillëdhënës (shih tekstin në rubrikë) të mbledhur nga Nisma për

ndryshim paqësor (PCi) sugjeruan se regjistrimet e popullsisë do të mund të ofronin një mundësi për të ndërtuar praktika bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile në të dyja vendet, rreth çështjeve që trajtojnë integrimin e pakicave. Ashtu si në Serbi, në regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë ishte parë bojkoti nga komuniteti pakicë.

Grupi Këshillëdhënës për projektin Fuqizimi i zërave lokalë

Në kuadër të projektit tre-vjeçar Fuqizimi i zërave lokalë për zhvillim të barabartë, Nisma për ndryshim paqësor (PCi) thirri takime të rregullta të Grupi Këshillëdhënës, të përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile, gazetarisë dhe akademisë, me qëllim që (1) të ofrojë reflektime të rregullta mbi progresin e përgjithshëm të aktivitetet, që përfshinin një gamë të gjerë fushash dhe specializimesh, dhe (2) të shikohet se si aktivitetet mund të kenë ndikim më strategjik në kontekstin e përgjithshëm të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, për shembull, përmes mundësive të reja për bashkëpunim, shkëmbim dhe mësim, ose avokim më të gjerë mbi temat që preken nga projekti.

Gjatë takimeve të para të Grupit Këshillëdhënës, u vlerësua se do të kishte mundësia që aktivitetet e regjistrimit të popullsisë të mbahen në Kosovë dhe Serbi në të njëjtën kohë dhe se këto mund të krijojnë skenën për bashkëpunim kuptimplotë dhe praktik ndërmjet grupeve të shoqërisë civile. Analiza e përbashkët e konteksteve rreth regjistrimeve të parashikuara të popullsisë dhe ndikimi që mangësitë në regjistrimet e mëparshme të popullsisë në të dyja vendet kishin pasur në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, vendeve dhe institucioneve, vendosën parametrat për këtë nismë.

Materiale të Shtypura
Credit: Agon Islami



Hoxhë Vesim Avdiu, Imam i Xhamisë së Strukarëve në Tërnoc të Madh, Bujanoc
Credit: Agon Islami

Pavarësisht përmirësimit të procedurave, mbetën shqetësime të konsiderueshme sa i përket kryerjes së regjistrimit të popullsisë. Veçanërisht, aktivistët nga komuniteti shqiptar ishin të brengosur se një popullatë që më parë kishte lejuar të anashkaloheshin në regjistrimin e popullsisë, ata mund të mos jenë të motivuar për t'u siguruar që ata të numërohen dhe, për më tepër, se ata nuk janë në dijeni të ndikimit që do të mund të kishte nën-numërimi në mirëqenien e tyre në të ardhmen. Kishte frikë se informatat në lidhje me atë se si të sigurohen që do të numërohen mund të mos arrinte tek disa njerëz - veçanërisht në komunitetet më të izoluar. Në këtë rast, një fushatë informuese e qeverisë në lidhje me regjistrimin e popullsisë nuk ishte veçanërisht e gjerë dhe la një boshllëk që duhej plotësuar. Posaçërisht shqetësuese ishte se qeveria fushatën e saj e mbështeste tek radioja, e cila nuk i shërbente në masë të duhur komunitetit shqipfolës. Ekzistonte shqetësim edhe sa i përket numrit të regjistruarëve që po dërgoheshin në terren dhe se sa ata e zotëronin gjuhën shqipe.

Fushata për të plotësuar boshllëkun e informacionit u zhvillua nga një aleancë e organizatave qytetare dhe aktivistëve të veçantë nga komuniteti shqiptar. Një konsorcium i thirrur nga Qendra për Demokraci dhe Arsim - Lugina (përfutuese e financimit për këtë iniciativë) përfshinte organizatat joqeveritare Beyond (Bujanoc), The Future (Bujanoc) dhe Budi Aktivan 16 (Preshevë). Aleanca angazhoi aktivistët e njohur civilë si Lirona Zuka dhe Agim Kadriu, si dhe mediat lokale RTV Presheva, TV Info Puls Vranje, Portali FOLonline dhe Wikiliks. Për më tepër, iniciativa mori mbështetje të profilit të lartë nga Këshilli Kombëtar Shqiptar, si dhe nga politikanë, akademikë dhe profesionistë të tjerë të shquar shqiptarë në Serbi, shumë prej të cilëve u përfshinë në materialin publicitar të zhvilluar për fushatën dhe ndihmuan në promovimin e saj drejtpërdrejt përmes tyre mediave të tyre dhe pranisë së rrjetë sociale.

Një gamë e larmishme produktesh, mjetesh dhe aktiviteteve u përdorën si pjesë e fushatës:

- Tre videoklipe, të përgatitura për transmetim në televizionin lokal
- Një platformë interaktive në internet, e cila u mundësoi komuniteteve të kishin qasje në informatat rreth regjistrimit të popullsisë dhe të merrnin përgjigje për pyetjet e tyre
- Një grup në Viber për të vepruar si një kanal plotësues për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të shpërndarë informata rreth regjistrimit të popullsisë
- Billborde dhe materiale të shtypura për të ofruar informata rreth regjistrimit të popullsisë
- Vizita personale në komunitetet që janë posaçërisht të izoluara.

Është shumë me rëndësi që udhëheqja qendrore e fushatës veprimi edhe si bashkëbiseduese ndërmjet

Enti i Statistikave të Republikës së Serbisë dhe popullatës së përgjithshme. Ndërveprimi në fazën e hershme me stafin e Entit të Statistikave të Republikës së Serbisë të Qarkut Pčinja u krijua për të mbledhur informata të sakta që mund t'i jepeshin popullatës - dhe, më vonë, ky kontakt u përdor më tej për t'i adresuar pyetjet që lindën gjatë procesit. (për shembull përmes kanaleve interaktive të komunikimit të ueb portalit ose grupit në Viber). Partneriteti me shërbimet shtetërore ishte një komponent thelbësor i një fushate informative të besueshme, por gjithashtu vuri në pah disa nga kufizimet e vetë agjencive shtetërore. Ndërsa zyrtarët ishin të prirur të ndihmonin me informata, ata nuk dukej se ishin të përgatitur që të angazhoheshin në një shkallë që do t'i vendoste ata në vijën e parë të pyetjeve që shtroheshin nga publiku. Zyrtarët refuzuan të lejojnë që detajet e kontaktit të shërbimeve të tyre të përdoren në fushatën informative.



Billboard në fshatin Turi të Bujanocit, duke i inkurajuar njerëzit që të regjistrohen së bashku me familjet e tyre
Credit: Agon Islami

Në fushatën online përgjithësisht u regjistruan 400,000 shfaqjet. Në portalin online u regjistruan më shumë se 40,000 vizita. Rreth 200-300 pyetje u përgjigjën përmes grupit në Viber. U kryen udhëtime në komunitetet e izoluar, gjithsej 220 vizita derë më derë.

“Regjistrimi është një proces në të cilin ne kemi vendosur të marrim pjesë. Nga regjistrimi do të varet jo vetëm politika ekonomike dhe zhvillimore, por edhe niveli i të drejtave që do të kemi në dhjetë vitet e ardhshme. Për të përmirësuar politikën ekonomike, për të përmirësuar të drejtat tona, ju dhe familja juaj duhet të regjistroheni.”

”

Shaip Kamberi
deputet i Kuvendit Popullor të Serbisë

“Ky është një moment historik për ta regjistruar çdo shqiptar. Në këto kushte të përmirësuar të gjithë kanë përgjegjësi pavarësisht statusit social, pavarësisht se ku jetojnë dhe si jetojnë, ne duhet t'i regjistrojmë të gjithë që të kemi një numër të saktë nga i cili varet përfaqësimi, varet edhe drejtimi i institucioneve. Të forcohen shqiptarët, të forcohen institucionet.”

”

Ragmi Mustafi
kryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptar

“Përkundër vlerësimeve të ndryshme, shqiptarët janë ende shumicë dhe kjo kërkon domosdoshmërisht rikonfirmimin tonë se jemi në numër më të madh. Atëherë thuaj po regjistrimit dhe dëshmo që je shqiptar.”

”

Enver Ramadani
kryetar i Kuvendit Komunal të Bujanocit

Problemet e tjera teknike nuk mund të adresoheshin. Me sa duket ishte bërë përparim në ofrimin e përkrahjes gjuhësore, por kjo ishte jashtëzakonisht e kufizuar. Ka pakënaqësi të vazhdueshme për numërimin e personave në Medvegjë, ku u ndje se shërbimi shtetëror nuk u përgjigjej shqetësimeve që shtroheshin nga anëtarët e nismës, si dhe mungesa e kontaktit me komunitetin shqiptar në Medvegjë. ishte e dukshme për ekipin e fushatës, i cili raportoi:

“Të vetmet njoftime në gjuhën shqipe për procesin e regjistrimit ishin nga portali Lugalajm (postere, fletushka), ndërsa Radio Medvegja, si media e vetme, nuk ofroi asnjë minutë program në gjuhën shqipe dhe nuk transmetoi një thirrje e vetme për regjistrimin e shqiptarëve atje.”

”

Raporti i projektit post-hoc

Ndikimi social i regjistrimit të popullsisë

Në regjistrimin e popullsisë llogariteshin rreth 61,000 shqiptarë etnikë në Serbi. Nja 37,000 të tjerë llogariten si qytetarë të Serbisë, por rezidentë jashtë vendit (dhe për këtë arsye nuk do të paraqiteshin si pjesë e përlogaritjes për ndarjen e resurseve qeveritare). Partneriteti zbatues e vlerësoi fushatën si sukses dhe ka shenja se kjo ka pasur ndikim për komunitetin shqiptar. Përveç se do të ketë ndryshime në shifrat që lidhen me ndarjet e buxhetit lokal, dy persona nga komuniteti shqiptar janë caktuar në komisione në Ministrinë e Arsimit dhe kuptohet që më shumë shqiptarë do të punësohen në shërbimin shëndetësor shtetëror. Rritje e buxhetit është caktuar edhe për Këshillin Kombëtar Shqiptar. Gjithashtu ka shenja se Trupi Koordinues po punon në atë mënyrë që e afron atë me komunitetin shqiptar, që shefi i zyrës të jetë më i pranishëm me vizita në atë rajon. Kur kundër pjesëtarëve të komunitetit shqiptar u drejtua sulm më 2 tetor, pas rritjes së tensioneve për shkak të ngjarjeve në Kosovë, Trupi Koordinues ndërhyri në emër të komunitetit.

Aktiviteti i numërimit, megjithatë, nuk i zbuti tensionet politike rreth marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve dhe shtetit serb, dhe ndonëse fushata informuese demonstroi disa aspekte të një partneriteti konstruktiv ndërmjet shoqërisë civile dhe agjencive shtetërore, tensionet politike shpesh kishin funksion të kundërt. Retorika nga presidenti serb Aleksandar Vuçiq, ndërkohë që numërimi ishte ende në vazhdim, dukej se minonte çfarëdo rezultati që mund të vinte nga numërimi në zonat shqiptare. Ai deklaroi se edhe pas regjistrimit të popullsisë nuk do të dihet numri i saktë i shqiptarëve në Serbi, sepse “shumë familje shqiptare raportojnë anëtarë të familjes që janë larguar dhe nuk jetojnë më atje”³. Deklarata mori një përgjigje nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ku theksohej dimension



Vizitë personale në komunitetin e izoluar me aktivisten qytetare Lirona Zuka, fshati Sjarinë, Medvegjë
Credit: Agon Islami


ndërkombëtar i aktivitetit të regjistrimit të popullsisë dhe lidhja e ngushtë të tij me konfliktin e stërzgatur politik mbi Kosovën.

Ankesat u ngritën edhe për mënyrën se si u krye numërimi në komunën e Medvegjës, ku aktivistët raportuan se popullsia shqiptare ishte dukshëm e nënlllogaritur, me përgjegjësi specifike që vihej mbi zyrtarët lokalë. Këtu u vu re dërgimi në terren i regjistruarve shqipfolës veçanërisht të dobët. Në rezultatet e numërimit dolën që shqiptarë të regjistruar ishin 14.22% e popullsisë së komunës, që i vendos ata nën pragun prej 15% që kërkohet me Ligjin e Republikës së Serbisë për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit për të mbështetur dygjuhësinë në nivel të njësisë së vetëqeverisjes lokale. Pas regjistrimit të popullsisë, nga monitorimi i situatës në Serbinë jugore ende vërehet qëndrimi jo bashkëpunues i autoriteteve lokale dhe kjo është një ankesë e komunitetit shqiptar.

Pavarësisht nga këto mangësi, përpjekjet e koordinuara dhe të përkushtuara nga komuniteti shqiptar nxjerrin në pah vendosmërinë për t'i kërkuar të drejtat e tyre si qytetarë të Serbisë dhe theksojnë përkushtimin e tyre për integrim mbi dhe përtej çdo ndarje nga shteti i Serbisë.

³ [Bujanovacke website, 26 October 2023, “Vucic: Albanci na popisu prijavljuju ljude koji godinama ne zive u Srbiji”](#)

⁴ [Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut \(2023\), Pasivizimi i adresave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës si praktikë diskriminuese, f.17](#)



Pamjet të fushatës në rrjetet sociale

Mësimet e nxjerrad

Konsorciumi përgatiti një sërë vëzhgimesh të veta relevante për institucionet serbe, të përmbledhura si shtatë rekomandime:

- 1. Mos e politizoni procesin e regjistrimit.**
 Arsyeja e saktë e refuzimit për t'u përfshirë në një numërim të plotë në komunën e Medvegjës nuk është e qartë, por mund të interpretohet si përpjekje politike për të ulur numrin zyrtar të shqiptarëve në atë zonë.
- 2. Sigurohuni që aplikacioni digjital të jetë i testuar mirë dhe t'i përshtatet qëllimit.**
 Janë regjistruar raste të mosfunksionimit të aplikacionit, si dhe probleme të caktuara në regjistrimin e familjarëve.
- 3. Siguroni një qasje profesionale për vendosjen e regjistruessve në terren.**
 Ka pasur ankesa se nuk ka mjaftueshëm regjistruess, se regjistruessit janë të përgatitur dobët dhe ishte paraqitur nevoja për zëvendësime të vonuara për të kompensuar numrat e stafit që e kishin braktisur aktivitetin (me sa duket për shkak të pagave të ulëta). Stimujt e pagesës për regjistruessit, bazuar në një llogaritje për familje, nuk ishin të përshtatshme për zona të caktuara - dhe nuk nxitën që regjistrimi i popullsisë të arrinte deri në zonat e largëta.
- 4. Zotohuni për një fushatë informimi që përfshin gjuhët lokale.**
 Mbështetja e vetme informative për shqiptarët në zonat e synuara ishte një grup broshurash nga Enti i Statistikave të Republikës së Serbisë. Kjo ishte një anashkalim serioz, duke marrë parasysh bojkotet e mëparshme të regjistrimit të popullsisë nga kjo pjesë e popullsisë.
- 5. Ofroni mbështetje telefonike për qytetarët.**
 Mungesa e një shërbimi telefonik bëri që qytetarët t'u drejtoheshin administratorëve komunalë për informata rreth numërimit, duke shkaktuar presion shtesë mbi administratat, e për pasojë joefikasitet.
- 6. Ngritni një mbikëqyrje ndërkombëtare për procesin.**
 Konteksti i marrëdhënieve shqiptaro-serbe ndikon në besimin e komuniteteve në proces, i cili u dëmtua më tej nga deklaratat e figurave politike. Monitorimi i ngushtë ndërkombëtar do t'i kishte hequr fushat e dyshimit.
- 7. Lejoni anëtarët e familjes ta regjistrojnë diasporën, pasi kjo e forcon besimin.**
 Një proces që lejon që personat që nuk janë aktualisht rezidentë të numërohen, e ndërton besimin dhe nuk bën presion shtesë që ata/ato të kthehen vetëm sa për t'u numëruar.

Konkluzione për ndërtimin e paqes

Karakteristikat teknike që lidhen me kryerjen e regjistrimeve të popullsisë në kontekste politikisht të ndjeshme mbartin në vete implikime të caktuara për politikën, praktikën dhe sjelljet që ndikojnë në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve. Rasti i regjistrimit të popullsisë në Serbinë jugore sugjeron që:

- Mangësitë në procedurat teknike të kryerjes së një regjistrimi të popullsisë, si përgatitja e dobët e regjistruarëve, dështimet e teknologjisë, udhëzimet e paqarta, etj. ka të ngjarë të nënkuptohen si diskriminim në sytë e komuniteteve të marginalizuara ose të atyre pakicë, madje edhe kur ato janë gabime ose standarde që ndikojnë në tërë popullatën. Ndarja proaktive e mjeteve shtesë për të arritur deri te grupet e marginalizuara, mund të zvogëlojë mundësinë e ankesave të vazhdueshme.
- Aty ku është e mundur, mësimet e caktuara praktike të mbledhura nga njerëz dhe organizata që kanë punuar në një kontekst të drejtpërdrejtë të regjistrimit të popullsisë, duhet të studiohen thellë kur planifikohen veprimtari të tjera të tilla në mjedise të pas-konfliktit ose në ato të ndjeshme. Këto mësimet duhet të shihen si një e mirë publike që mund të ndahet me kolegët ose të ruhet për konsultime në të ardhmen.
- Udhëheqja politike ishte një parakusht vendimtar për të krijuar hapësirën e duhur për të vepruar. Roli i saktë i ndërmjetësimit ndërkombëtar nuk dihet, por vizibiliteti që i është dhënë OSBE-së ishte një faktor mundësues për ndërtimin e besimit në regjistrimin e popullsisë si tërësi dhe i dha lidhshirësi politik dhe atij qytetar në komunitetin shqiptar hapësirën për mobilizimin e njerëzve për të marrë pjesë.
- Ndërgjegjësimi i popullatës nuk duhet marrë si i mirëqenë, jo vetëm në lidhje me praktikën e detajuar të numërimit, por edhe kur bëhet fjalë për faktin se po zhvillohet një regjistrim i popullsisë. Kjo sidomos ndodh në rastin e pakicave që i janë nënshtruar ndonjë forme të abstenimit në të kaluarën. Dërgimi i informacionit të përshtatshëm, të qasshëm dhe në kohë për këto grupe duhet të planifikohet që në fillim.
- Shoqëria civile mund të luajë rol të rëndësishëm si në planifikimin, ashtu edhe në ofrimin e fushatave informative. Aktivistët e shoqërisë civile janë përgjithësisht të pozicionuar mirë për t'i kuptuar më mirë barrierat sa i përket pjesëmarrjes ose disponueshmërisë së informacionit. Organizatat e shoqërisë civile shpesh kanë një sërë aftësish të përshtatshme për të nxitur angazhimin dhe për të ndërtuar besimin.
- Partneriteti konstruktiv me agjencitë qeveritare është i rëndësishëm. Veprimet e ndërmarra nga shoqëria civile duhet t'u mundësojnë agjencive qeveritare ta përmirësojnë punën e tyre, në vend që të veprojnë për t'i zëvendësuar ato (edhe pse në disa raste organizatat e shoqërisë civile mund t'u duhet të punojnë në emër të tyre). Në interes të ndërtimit të besimit, mesazhet nga organizatat e shoqërisë civile duhet të synojnë të rrisin besueshmërinë e agjencive qeveritare në vend që t'i nënvizojnë mangësitë e tyre.
- Në qendër të narrativave që shpërndahen në zonat e pakicave ose të grupeve të marginalizuara, duhet të jenë mesazhet që përcjellin një ndjenjë se pse pjesëmarrja është e rëndësishme dhe e dobishme për komunitetin. Në rastin e Serbisë jugore, pjesëmarrja kishte për qëllim të nxirrte mjete më të mëdha nga qeveria të cilat do të ndikonin pozitivisht në mirëqenien e komunitetit, por po aq të rëndësishme mund të jenë edhe mesazhet që vënë theksin në forcimin e identitetit lokal.
- Pjesëmarrja në veprimtari të tilla, e rrit ndjenjën e angazhimit qytetar. Pjesëmarrja masive duhet të inkurajohet dhe të përgëzohet si një demonstrim i përkatësisë lokale, pavarësisht nga tregimet kundërvënëse nga aktorët politikë. Shoqëria civile nga komunitetet shumicë mund të kontribuojë ndjeshëm në ndjenjën e integritetit të një pakice, duke punuar me vullnetin e tyre për t'u angazhuar dhe përfshirë, edhe kur kjo përcillet me artikullim aktiv të pakënaqësisë.



Mohim përgjegjësie: Ky material është financuar nga UK Aid e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.



email: agonislami@hotmail.com

Numri i telefonit: +381637396789

Faqja e internetit: <https://luginalajmi.com/>

Fuqizimi i zërave lokalë për zhvillim të barabartë (ALVED) është një projekt 30-mujor i financuar nga Fondi për Konfliktet, Sigurinë dhe Stabilitetin të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatuar nga një konsorcium organizatash që përfshijnë (PCi), (People in Need), Građanske Inicijative (Serbi), Peer Educators Network dhe Aktiv (të dyja nga Kosova).

Projekti synon të promovojë, eksplorojë, zhvillojë dhe zbatojë praktika inovative që mundësojnë vendim-marrje pjesëmarrëse që është e suksesshme në kapërcimin e barrierave ndërmjet grupeve të ndryshme në Serbi dhe në Kosovë, dhe t'i angazhojë palët e interesuara të projektit në analizimin e kontekstit në të cilin zhvillohet kjo punë, me pikëpamjen për të ndërmarrë veprime bashkëpunuese dhe strategjike për të kontribuar në një mjedis më të favorshëm ku demokracia gjithëpërfshirëse të lulëzojë e dhe që të ketë ndikim pozitiv në jetën e njerëzve të zakonshëm.

Qendra për Demokraci dhe Edukim - Lugina, është një organizatë vullnetare, joqeveritare dhe jofitimprurëse, e krijuar me misionin gjithëpërfshirës të avancimit të objektivave në sferën e shpërndarjes së informacionit, shprehjes kulturore dhe artistike, edukimit dhe mbrojtjes së mjedisit. Përtej objektivave të saj kryesore, organizata angazhohet në mënyrë aktive në promovimin e barazisë gjinore, tolerancës, të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave kombëtare. Që nga viti 2013, në kuadër të Qendrës për Demokraci dhe Edukim - Lugina, është krijuar një portal informativ në gjuhën shqipe 'Lugina Lajm'. Gjatë dekadës së fundit Portali 'Lugina Lajm' ka realizuar projekte të shumta, duke vendosur kontakte dhe bashkëpunime të fuqishme me institucionet lokale dhe shtetërore, si dhe me organizata ndërkombëtare.



25B Lloyd Baker Street
London, WC1X 9AT
United Kingdom

europe.southcaucasus@peacefulchange.org

www.peacefulchange.org

Peaceful Change initiative -PCi (Nisma për ndryshim paqësor) është një organizatë për ndërtim të paqes që përpiqet për një botë pa konflikte të dhunshme. Për ta arritur këtë, ne punojmë me komunitetet dhe udhëheqësit e tyre për t'u përballur me nxitësit e konfliktit të dhunshëm. Së bashku, ne ndërtojmë kushtet që e bëjnë të mundur paqen e qëndrueshme.

Ne krijojmë njohuri të thella dhe partneritete të forta aty ku punojmë. Kjo na mundëson të bëjmë punën afatgjatë për ndërtim të paqes së qëndrueshme dhe të përgjigjemi me shpejtësi dhe në mënyrë efektive ndaj krizave.

Ne punojmë vetëm aty ku e dimë se mund të bëjmë një ndryshim të vërtetë në jetën e njerëzve. Shumë komunitete me të cilat ne punojmë, i kanë menaxhuar me sukses konfliktet me rrezik të lartë dhe kanë shmangur dhunën, madje edhe kur proceset formale të paqes kanë dështuar.